

AUTORITETET LOKALE NË KOSOVË PAS VITIT 1999 U GJENDËN TË PAPËRGATITURA TË PËRBALLOJNË TRENDIN E URBANIZIMIT DHE PLANIFIKIMIT TË MIRËFILLTË TË QYTETEVE TONA E CILA U MANIFESTUA EDHE ME NUMËR TË MADH TË NDËRTIMEVE PA LEJE. ZGJERIMI I QYTETEVE NË KOSOVË PËRPOS PLANEVE TË PAZBATUESHME NË TERREN U PËRCJELL ME ZVOGËLIMIN E TOKAVE BUJQËSORE, MUNGESË TË INFRASTRUKTURËS, SHËRBIMEVE SOCIALE DHE PROBLEME MJEDISORE.

NË PËRPPJEKJET PËR TË ARRITUR PLANIFIKIM EFEKTIV HAPËSINOR, LIGJI NR. 2003/14 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR I KOSOVËS U PËRDITËSUA ME LIGJIN E RI 04/L-174 I CILI KA PREZANTUAR STRUKTURËN E RE TË DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR SI NË NIVELIN QENDROR ASHTU EDHE NË ATË LOKAL, TË VENDOSURA NË NJË SISTEM HIERARKIK DHE INTERAKTIV. TË DY NIVELET KANË PLANE MULTI-SEKTORALE TË KARAKTERIT STRATEGJIK SI PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS (PHK) DHE PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK) SI DHE NJË LLOJ TË RI TË PLANEVE QË KANË MË TEPËR KARAKTER RREGULLUES/ZBATUES SI HARTA ZONALE E KOSOVËS DHE HARTA ZONALE E KOMUNËS. KËTO PLANE, EDHE PSE TË NDËRLIDHURA, JANË DOKUMENTE TË VEÇANTA QË ZHVILLOHEN DHE MIRATOHEN NËPËRMJET PROCEDURAVE TË VEÇANTA DHE NË MËNYRË TË NJËPASNJËSHME. DISA NGA KOMUNAT E KOSOVËS, TANIMË VEÇSE I KANË APROVUAR HZK E TYRE E DISA JANË NË PROCES TË HARTIMIT BASHKË ME PZHK-TË PËRKATËSE.

EC MA ND RYSHE KA HARTUAR NJË PYETËSOR DEDIKUAR KOMUNAVE TË KOSOVËS KU ËSHTË TENTUAR TË MERRREN INFORMATA RRETH PROCESIVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR PËRFSHIRË DHE SFIDAT QË JANË PARAQITUR GJATË KËTYRE PROCESIVE. PYETËSORI I ËSHTË DËRGUAR DREJTORIVE PËRKATËSE TË URBANIZIMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË TË GJITHA KOMUNAT E KOSOVËS. NGA GJITHSEJ 38 KOMUNA NË VEND, JANË PËRGJIGJUR GJITHSEJ 20 PREJ TYRE. NË VIJIM JANË PARAQITUR GJETJET E HULUMTIMIT DHE PËRGJIGJET E SIGURARA DERI MË 15 QERSHOR 2021 NGA PËRFAQËSUESIT E INSTITUCIONEVE LOKALE.

KY AKTIVITET PËRKRAHET NGA PROGRAMI I FONDACIONIT KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE (KCSF) 'EJA KOSOVË', BASHKËFINANCIUAR NGA AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM (SDC) DHE AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)

PLANIFIKIMI HAPËSINOR

KOMUNAT

DEÇAN

DRAGASH

GLLOGOC

GJAKOVË

GJILAN

ISTOG

JUNIK

KAMENICË

KLINË

LIPJAN

MAMUSHË

MITROVICË JUGORE

PODUJEVË

PRIZREN

RAHOVEC

RANILLUG


SUHAREKË

SHTIME

VITI

VUSHTRRI

DHE URBAN NË KOMUNAT E KOSOVËS



SHTATOR 2021

1. A KA KOMUNA JUAJ PLAN ZHVILLIMOR KOMUNAL NË FUQI?

OPSIONET (NUMRI I KOMUNAVE)

A) PO (14)

70%

B) JEMI NË PROCES TË HARTIMIT TË PZHK-SË RE ME KËRKESAT E LIGJIT TË RI TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (6)

30%

C) JO (0)

0%

2. A KENI PLAN ZHVILLIMOR URBAN NË FUQI ME TË CILËN PUNON KOMUNA E JUAJ?

A) PO (15)

75%

B) JO (5)

25%

3. CILI ËSHTË MENDIMI I JUAJ, NËSE “KUFIRI URBAN APO ZONA URBANE” (NË BAZË TË LIGJIT TË MËPARSHËM TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR 2003/4), KA NDIHMUAR APO JO NË MENAXHIM TË HAPËSIRËS SE KOMUNËS SUAJ?

A) PO, KA NDIHMUAR (12)

60%

B) JO, NUK KA NDIHMUAR PASI QË KA PASUR KËRKESA PËR ZGJERIM TË MËTEJTMË (3)

15%



C) JO, NUK KA NDIHMUAR PASI QË NUK ËSHTË RESPEKTUAR NË TERREN (5)

25%

EC
MA NDËRYSHE

PLANIFIKIMI
HAPËSINOR
DHE URBAN
NË KOMUNAT
E KOSOVËS

4. SA NËN-ZONA I KENI NË QYTETIN TUAJ TË PËRCAKTUAR ME PLANIN ZHVILLIMOR URBAN DHE SA PREJ TYRE KANË TË APROVUAR PLANET RREGULLUESE URBANE?



PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBAN NË KOMUNAT E KOSOVËS

5. A KENI INTERESIM PËR NDËRTIME BANESORE TË LARTA NË KOMUNËN TUAJ?

OPSIONET (NUMRI I KOMUNAVE)

A) SHUMË (4)

20%

B) MESATARISHT (10)

50%

C) PAK (4)

20%

D) JO (2)

10%

6. SI MENAXHOHET NDËRTIMI NËPËR FSHATRA TË KOMUNËS SUAJ?

A) ZBATOHEN DISPOZITAT E LIGJIT PËR NDËRTIM (7)

35%

B) BANORËT NUK APLIKOJNË/ KËRKOJNË LEJE (11)

55%

C) KA NUMËR SHUMË TË VOGËL TË APLIKIMEVE (2)

10%

7. GJATË PUNËS SUAJ, CILAT PËRPARËSI DHE MANGËSI I KENI HASUR NË ZBATIMIN E LIGJIT TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR TË VITIT 2003 DHE TË ATIJ TË VITIT 2013?

LIGJI I VJETËR (2003)		LIGJI I RI (2013)	
PËRPARËSITË	MANGËSITË	PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> ● METODOLOGJI MË TË LEHTË PËR HARTIM TË DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR ● DEFINIMI I ZONAVE NË KOMUNË, SIKURSE: ZONA BUJQESORE, ZONA NDËRTIMORE, ZONA KOMERCIALE, ZONA INDUSTRIALE, ZONA PYJORE ETJ. 	<ul style="list-style-type: none"> ● ZBATIMI I KOMOSACIONIT URBAN ● NDËRTIMET PA LEJE TË PATRAJTUARA ● MUNGESA E FONDEVE KOMUNALE PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE TË PARASHIKUARA NË PLANE. ● NIVELI I HARTIMIT TË PRRU-VE NUK KA QENË SHUMË E DETAJIZUAR ● MUNGESA E STAFIT ADEKUAT PROFESIONAL; MUNGESA E PËRVOJËS PËR HARTIMIN E PLANEVE HAPËSINORE. 	<ul style="list-style-type: none"> ● KY LIGJ ËSHTË MË I AVANCUAR DHE GJITH-PËRFSHIRËS DHE TRAJTON PROBLEMATIKAT NË MËNYRË MË PRAKTIKE. ● DEFINIMI I ZONAVE NË KOMUNË, SIKURSE: ZONA BUJQESORE, ZONA NDËRTIMORE, ZONA KOMERCIALE, ZONA INDUSTRIALE, ZONA PYJORE ETJ 	<ul style="list-style-type: none"> ● KA NEVOJË PËR NJË INTERPRETIM MË TË QARTË TË LIGJIT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR MËNYRË QË TË EVITOHEM PROBLEMET GJATË ZBATIMIT TË TIJ. ● SHQETËSIMI RRETH PAQARTËSIVE NË INTERPRETIMIN LIGJOR NË LIDHJE ME REVIDIMIN E PZHK. ● SIGURIMI I TË DHËNAVE TË AZHURNUARA PËR FUSHAT TEMATIKE TË LARTPËRMENDURA, SI NJË NGA PROBLEMET KRYESORE QË E PËRCJELLIN PROCESIN E PLANIFIKIMIT (TË DHËNA QË KËRKOHEM SIPAS UA). ● ZBATIMI I KOMOSACIONIT URBAN ● MANGËSI FLEKSIBILITETI E NDRYSHIMEVE TË VOGLA BRENDA PERIUDHES KOHORE TË PARAPARË NË TRE DOKUMENTET E NIVELIT KOMUNAL E SIDOMOS NË KUADËR TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME! ● NDËRTIMET PA LEJE TË PATRAJTUARA. ● MUNGESA E FONDEVE KOMUNALE PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTEVE TË PARASHIKUARA NË PLANE. ● MUNGESA E STAFIT ADEKUAT PROFESIONAL; MUNGESA E PËRVOJËS PËR HARTIMIN E PLANEVE HAPËSINORE. ● MUNGESA E KODIT NDËRTIMOR.

EC
MA NDRYSHE

PLANIFIKIMI
HAPËSINOR
DHE URBAN
NË KOMUNAT
E KOSOVËS

8. A KENI HARTUAR DERI TASH NDOJË DOKUMENT APO HULUMTIM SE SA JANË ZBATUAR DISPOZITAT E PZHK-SË, PZHU-SË APO PRRU-SË (PRRU-VE) PËR KOMUNËN TUAJ?

OPSIONET (NUMRI I KOMUNAVE)

A) PO (9)

45%

B) JO (11)

55%

KOMUNAT ME PËRGJIGJE POZITIVE KRYESISHT KANË BËRË VETËM NJË VLERËSIM TË PËRGJITHSHËM OSE KANË HARTUAR DOKUMENTIN VLERËSUES GJATË FAZËS SË HARTIMIT TË HZK-SË SË TYRE. VETËM DY KOMUNA KANË RAPORTUAR SE PLANET E TYRE HAPËSINORE E URBANE JANË ZBATUAR NË NIVEL 60% GJEGJËSISHT 40%.

9. CILAT KANË QENË SFIDAT DHE PROBLEMET KRYESORE TË ZBATIMIT TË PZHK-SË, PZHU-SË DHE PRRU-VE NË KOMUNËN TUAJ, DOKUMENTE KËTO SIPAS LIGJIT PARAPRAK PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR?

- MUNGESA E STAFIT TË MJAFTUESHËM PROFESIONAL.
- NDËRTIMET PA LEJE.
- INFORMIMI I PAMJAFTUESHËM I POPULLSISË PËR KUSHTET E NDËRTIMIT DHE RREGULLAT QË JANË NË FUQI PËR NDËRTIM.
- MOS PJESEMARRJA E QYTETARËVE NË DISKUTIME PUBLIKE.
- MOS FUNKSIONIMI I INSPEKTORATIT TË NDËRTIMIT NË ZBATIM TË PLANEVE.
- PAKËNAQËSITË E QYTETARËVE LIDHUR ME ETAZHITETIN E OBJEKTEVE DHE PËRQINDJEN E SHFRYTËZIMIT TE HAPËSIRËS.
- NDËRRIMI I KËRKESAVE TË GRUPEVE TË INTERESIT GJATË ZBATIMIT TË PRRU-VE.
- MUNGESA E MJETEVE BUXHETORE PËR SHPRONËSIMET E HAPËSIRAVE TË CILAT JANË PARAPARË PËR INTERES TË PËRGJITHSHËM!
- MUNGESA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PLANEVE TË APROVUARA.
- MOS-APLIKIMI PËR LEJE NDËRTIMORE NË ZONA RURALE.
- KËRKESA TË VAZHUESHME PËR NDËRTIM DHE ZGJERIM NË ZONA KU NUK ËSHTË PLANIFIKUAR NDËRTIMI.
- TEK PRRU- MOS PËRPUTHJA E KOEFICIENTIT ME LARTËSI, SI DHE PARCELA MINIMALE PËR NDËRTIM;
- TEK PZHK- MUNGESA E SOFTWAREVE PËR LEXIMIN E HARTAVE.

10. NË ÇFARË FAZE TË HARTIMIT JENI NË PROJEKTIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SUAJ, DOKUMENT KY SIPAS LIGJIT TË RI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR?

HZK ËSHTË E APROVUAR

KLINA.

NË FAZAT PËRFUNDIMTARE TË APROVIMIT TË DOKUMENTIT

PRIZREN, DEÇAN, GJILAN, ISTOG, LIPJAN, PODUJEVË, SHTIME, VITI, DRENAS.

NË FAZËN E DRAFTIT TË PARË TË DOKUMENTIT

GJAKOVË, RAHOVEC, SUHAREKË, VUSHTRI.

NË FAZAT FILLESTARE TË PROCESIT TË HARTIMIT

JUNIK, KAMENICË, MITROVICË JUGORE.

ENDE NUK ËSHTË FILLUAR PROCESI I HARTIMIT

DRAGASH, MAMUSHË, RANILLUG.

EC
MA NDËRYSHE

PLANIFIKIMI
HAPËSINOR
DHE URBAN
NË KOMUNAT
E KOSOVËS

11. SA KA QENË GJITHËPËRFSHIRËS PROCESI I HARTIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS (NËSE E KENI NISUR/PËRFUNDUAR PROCESIN) DHE A JANË KONSULTUAR QYTETARËT DHE PALËT E INTERESIT / HISEDARËT E NDRYSHËM GJATË KËTIJ PROCESI? NËSE PO, SA TAKIME ME QYTETARË JANË MBAJTUR DERI TASH?

- GJITHSEJ 11 KOMUNA NUK KANË FILLUAR OSE JANË NË PROCES TË HARTIMIT DHE NUK KANË DHËNË INFORMATA SE SA TAKIME JANË MBAJTUR DERI TANI.
- VETËM 9 KOMUNA JANË PËRGJIGJUR SE KANË MBAJTUR TAKIME ME QYTETARË, PREJ TË CILËVE VETËM 3 KANË DHËNË INFORMATA SPECIFIKE:
 - AFËRSISHT 20 TAKIME (KOMUNA E PRIZRENIT)
 - SË PAKU 30 TAKIME (KOMUNA E GJILANIT)
 - 8 DISKUTIME PUBLIKE (KOMUNA E PODUJEVËS)

12. SA KA QENË EFIKAS DHE PRAKTIK LIGJI I MËPARSHËM DHE LIGJI I RI I PLANIFIKIMIT RRETH PËRFSHIRJES SË QYTETARËVE NË PROCES TË HARTIMIT TË PLANEVE HAPËSINORE E URBANE?

OPSIONET (NUMRI I KOMUNAVE)

A) LIGJI I RI ËSHTË MË I MIRË (7)

35%

B) NUK KA DALLIM MES DY LIGJEVE NË ASPEKT TË PËRFSHIRJES SË QYTETARËVE (6)

30%

C) NEVOJITET TË AVANCOHET PËRFSHIRJA QYTETARE PASI QË ASNJËRA NUK KA QENË PLOTËSISHT EFIKASE DHE PRAKTIKE (7)


35%

EC
MA NDRYSHE

PLANIFIKIMI
HAPËSINOR
DHE URBAN
NË KOMUNAT
E KOSOVËS

13. A KA PLAN MOBILITETI KOMUNA JUAJ?

OPSIONET (NUMRI I KOMUNAVE)



14. SA I PËRKET MOBILITETIT/LËVIZSHMËRISË NË KOMUNËN TUAJ, A MENDONI SE PLANET EKZISTUESE HAPËSINORE E URBANE TRAJTOJNË MJAFTUESHËM SFIDAT QË PARAQITEN NË KËTË FUSHË?

